



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot:

1/345

Datë:

7 / 5 / 2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, në bazë të nenit 46, pika 1.4, nenit 73 dhe nenit 100 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe në bazë të Rregullores së përgjithshme për studime të doktoratës nr. 1/147, dt. 16.04.2026, në mbledhjet e mbajtura më 01.04.2026, respektivisht më 29. 04. 2026, vendosi të shpallë:

KONKURS

për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës në vitin akademik 2026/2027

1. Universiteti i Prishtinës, në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027, përmes këtij konkursi, do të pranojë deri në **61** studentë, në shtatë programe studimi në kuadër të katër fakulteteve.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, universiteti do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht deri në **9** studentë të rregullt nga komunitetet joshumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komunitetet joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve.

Fakulteti – Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Gjithsej
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE	4	1	5
Kimi	4	1	5
FAKULTETI I FILOLOGJISË	8	2	10
Gjuhësi	4	1	5
Letërsi	4	1	5
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE	11	1	12
Doktoratë në Inxhinieri elektrike dhe kompjuterike	11	1	12
FAKULTETI I MJEKËSISË	25	4	29
Mjekësi klinike	9	1	10
Mjekësi paraklinike	9	1	10
Stomatologji	4	1	5
Shëndet publik	3	1	4
FAKULTETI I EDUKIMIT	4	1	5
Doktoratë në Shkencat e Edukimit (program i përbashkët me Universitetin e Lubjanës)	4	1	5
GJITHSEJ	52	9	61

I. KUSHTET E KONKURSIT

1. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët me notë mesatare të të dy niveleve të studimeve (BSc + MSc)/2 \geq 8.00), jo më të ulët se 8, të diplomuar në njërin nga nivelet vijuese:
 - 1.1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
 - 1.2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të Deklaratës së Bolonjës, niveli i studimeve master shkencor;
 - 1.3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 ECTS. Ekuivalentimin e notave për studentë nga jashtë Kosovës e bën Komisioni për pranimin e studentëve.
2. Senati i universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës (KQSD), merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Lista me kandidatët e pranuar shpallet, me të gjitha të dhënat e kritereve të përzgjedhjes, publikisht në uebfaqen e njësisë akademike dhe në uebfaqen e universitetit.
3. Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit përkatës nga ana e tyre ku, përveç tjerash, duhet të përfshihen: letra motivuese, në të cilën arsyetohet interesi për kërkime shkencore/artistike në fushën përkatëse; koncepti ideor i hulumtimit; dëshmitë lidhur me suksesin në secilin nivel të studimeve paraprake; dëshmitë për njohjen e gjuhës angleze nga ndonjë institucion i njohur dhe i pranuar në nivel ndërkombëtar, si dhe letër zotimi apo konfirmimi i një profesori në fushën përkatëse se është i gatshëm të mentorojë kandidatin (mentor potencial) në temën përkatëse dhe i cili duhet të plotësojë kushtet për mentorim. Lista e plotë e dokumentacionit të nevojshëm për vlerësimin e kandidatëve specifikohet në konkursin publik.
4. Koncepti ideor i hulumtimit duhet të prezantohet dhe mbrohet para komisionit për vlerësimin e aplikantëve. Ky komision caktohet nga këshilli i fakultetit për secilin program dhe përbëhet nga anëtarë që i plotësojnë kriteret për mentorim. Komisioni bën vlerësimin e konceptit ideor, i cili duhet të përfshijë së paku komponentët në vijim:
 - Titulli;
 - Abstrakti;
 - Hyrja;
 - Çështja kërkimore, pyetja/et kërkimore dhe hipoteza/t;
 - Korniza teorike, literatura relevante;
 - Inovacioni, relevanca dhe kontributi i synuar shkencor;
 - Të dhënat dhe metodologjia e propozuar;
 - Metoda/t e analizës së të dhënave;
 - Plani i punës;
 - Referencat.

5. Koncepti ideor i hulumtimit vlerësohet deri në 40 pikë, kriteret e detajuara të vlerësimit të konceptit ideor përcaktohen për secilin program dhe shpallen në konkurs. Vlerësimi bazohet në qartësinë dhe rëndësinë shkencore të problemit kërkimor, koherencën ndërmjet qëllimeve, metodologjisë dhe analizës së propozuar, nivelin e inovacionit dhe kontributin e pritshëm shkencor, realizueshmërinë e hulumtimit brenda kohëzgjatjes së studimeve të doktoratës, aftësitë metodologjike dhe teknike, motivimin dhe angazhimin akademik, si dhe aftësitë e komunikimit akademik të aplikantit.
6. Analizë vlerësuese kritike e një artikulli shkencor të publikuar në një revistë shkencore ndërkombëtare kredibile, përkatësisht e një aktiviteti artistik nga fusha përkatëse; punimi shkencor ose aktiviteti artistik përzgjidhet nga komisioni vlerësues; kandidati e realizon vlerësimin dhe e prezanton atë në prani të komisionit gjatë periudhës së intervistimit, respektivisht testimit – deri në 20 pikë.
7. Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitjen e kandidatëve janë:
 - 7.1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike përkatëse, vlejné për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës dhe publikohen në konkurs, në kuadër të kushteve të veçanta për njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushave të kandidatëve, të cilët studimet i kanë kryer në fakultete ose në universitete të tjera, bëhet nga ana e Këshillit të studimeve të doktoratës, para se ata t'i nënshtrohen prezantimit publik.
 - 7.2. Nota mesatare gjatë studimeve në nivelin baçelor dhe master, përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 30 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike me 3.
 - 7.3. Aktiviteti kërkimor-shkencor/profesional, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me vlerë maksimale deri në 10 pikë:
 - 7.3.1. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuara në Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2): autori i parë/korrespondent 5 pikë, bashkautori 2 pikë;
 - 7.3.2. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në SCOPUS (Q3, Q4) autori i parë/korrespondent 3 pikë, bashkautori 1 pikë;
 - 7.3.3. Për fushën e mjekësisë për specializimin e përfunduar vlerësohet me 5 pikë.
 - 7.3.4. Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara: autori i parë 3 pikë, i dyti 2 pikë, të tjerët 1 pikë;
 - 7.3.5. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, të cilat i nënshtrohen recensionit shkencor: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë;

- 7.3.6. Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë;
- 7.3.7. Për çdo prezantim në formë poster të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore, të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë;
- 7.3.8. Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendor: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
8. Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të defnuara në rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelin akademik, nuk merren parasysh. Rregullorja në fuqi për studime të doktoratës e përcakton që ky kufizim është i aplikueshëm edhe në rastet e tjera kur bëhet fjalë për revista dhe botues të tyre.
9. Në rastin e pikëve të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
10. Çdo kandidat duhet të dëshmojë njohuri të gjuhës angleze, të paktën në nivelin B2, përkatësisht të ketë dëshmi nga testet ndërkombëtare të njohura, TOEFL iBT (minimumi 72 pikë) ose IELTS (minimumi 5.5) të administruara nga institucione të akredituara sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (CEFR). Certifikatat e TOEFL iBT dhe IELTS janë të vlefshme për 2 vjet nga data e lëshimit të tyre.
11. Njësitë akademike mund të vendosin kërkesa plotësuese, nëse të njëjtat nuk bien ndesh me Statutin e UP-së dhe me rregulloren në fuqi për doktorata.
12. Procesi i pranimit organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet në tërësi përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e procesit pranues. Në rastet e tilla senati i universitetit mund të kërkojë nga fakulteti që të marrë masa shtesë me qëllim të evitimit të diskreditimit të procesit pranues.

II. KUSHTET E VEÇANTA TË KONKURSIT, TË PËRCAKTUARA NGA FAKULTETET PËRKATËSE

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

1. Studime të doktoratës në Kimi

Vlejnë kriteret e përgjithshme të konkursit, bazuar në rregulloren në fuqi për studime të doktoratës në UP.

FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. Programi Letërsi

Ofrohet për kandidatët që kanë përfunduar studimet paraprake në këto programe të Fakultetit të Filologjisë, Universiteti i Prishtinës: Letërsi shqipe, Gjuhë dhe letërsi angleze (profili Letërsi), Gjuhë dhe letërsi frënge, Gjuhë dhe letërsi gjermane, Gjuhë dhe letërsi turke dhe Orientalistikë si dhe për kandidatët që kanë përfunduar studimet e profilizuara në fushën e letërsisë në përgjithësi. Kandidatët, për pjesën profesionale, do t'i nënshtrohen provimit për njohuritë nga fusha e letërsisë.

2. Programi Gjuhësi

Ofrohet për kandidatët që kanë përfunduar studimet paraprake brenda fushës së gjuhësisë në Fakultetin e Filologjisë, Universiteti i Prishtinës: Gjuhë shqipe, Gjuhë dhe letërsi angleze (profili Gjuhësi), Gjuhë dhe letërsi frënge, Gjuhë dhe letërsi gjermane, Gjuhë dhe letërsi turke dhe Orientalistikë si dhe për kandidatët që kanë përfunduar studimet e profilizuara në fushën e gjuhësisë në përgjithësi. Kandidatët, për pjesën profesionale, do t'i nënshtrohen provimit për njohuritë nga fusha e gjuhësisë.

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

1. Doktoratë në Inxhinieri elektrike dhe kompjuterike

1. Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake, baçelor dhe master, në *Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike*.
2. Nga pjesa profesionale e provimit pranues kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë (prej të cilave 18 pikë nga pjesa me shkrim dhe 12 pikë nga prezantimi para komisionit përkatës):
 - 2.1. Provimi me shkrim – nga metodologjia e hulumtimit shkencor dhe shkencave të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike. Kjo pjesë vlerësohet me 18 pikët e parapara nga provimi pranues.
 - 2.2. Koncepti ideor – të jetë maksimumi 3 faqe A4, fonti 12, pa hapësira dhe të përmbajë: përshkrimin e problemit hulumtues bazuar në literaturë të publikuar në revista prestigjioze, pyetjet hulumtuese, metodologjinë hulumtuese, një plan të hulumtimit, si dhe referencat përkatëse. Ky koncept, së bashku me prezantimin me gojë, vlerësohet me 12 pikët e parapara të provimit pranues.

FAKULTETI I MJEKËSISË

1. Programi Mjekësi klinike

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët i kanë përfunduar studimet paraprake në drejtimin *Mjekësi e përgjithshme*.

2. Programi Mjekësi paraklinike

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët i kanë përfunduar studimet paraprake në drejtimin *Mjekësi e përgjithshme dhe Farmaci*.

3. Programi Stomatologji

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në drejtimin *Stomatologji*.

4. Programi Shëndet publik

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në drejtimin *Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci*.

Për të gjitha programet, kriteret e detajuara për pranim do të bazohen në Rregulloren në fuqi për studimet e doktoratës, e cila u ofrohet komisioneve relevante të Fakultetit të Mjekësisë gjatë vlerësimit të aplikantëve dhe kërkesat specifike të programit.

Kandidatët në programet e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë, duhet të dorëzojë *Konceptin ideor të hulumtimit* origjinal në fushën përkatëse të programit të doktoratës ku aplikon.

Përmes konceptit ideor të hulumtimit, kandidati artikulon idenë hulumtuese, vizionin dhe metodologjinë e tij për zhvillimin e një projekti hulumtues në një fushë ose temë specifike të drejtimit përkatës. Koncepti ideor i hulumtimit duhet të përmbajë hyrjen me artikullimin e problemit hulumtues dhe mbështetjen me literaturë të publikuar në revista prestigjioze, pastaj rëndësinë shkencore të konceptit ideor të hulumtimit, qëllimet, hipotezat dhe metodologjinë e përmbledhur, me të cilën planifikohet ai hulumtim, si dhe literaturën (së paku 10 referenca përkatëse).

Në aspektin teknik, ky propozim duhet të paraqitet përmes një teksti të shkruar prej më së shumti 3 faqeve të programit *Word*, me madhësi shkronjash nr.12 dhe pa hapësira midis rreshtave.

FAKULTETI I EDUKIMIT

1. Programi i Doktoratës në Shkencat e Edukimit

Ky është program i përbashkët me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Lubjanës, sipas formës “Diplomë e dyfishtë”, dhe ofrohet në gjuhën angleze. Prandaj, parakusht për të aplikuar në këtë program është dëshmia nga testet e njohura ndërkombëtarisht, TOEFL dhe IELTS, që janë administruar nga institucionet e akredituara sipas kornizës së përbashkët evropiane të referencës për gjuhët (CEFR) sipas dispozitave të konkursit dhe rregullores në fuqi. Po ashtu, koncepti ideor duhet të shkruhet e paraqitet në gjuhën angleze.

Provimi pranues:

- Koncepti ideor i hulumtimit: 40 pikë që mund të merren nga prezantimi dhe arsyetimi i projektit hulumtues/konceptit ideor të hulumtimit. Ky koncept përfshin arsyeshmërinë, qëllimin dhe pyetjet e hulumtimit (jo më gjatë se pesë faqe). Vlerësimi i projektit ideor bëhet sipas kriterëve për një hulumtim cilësor, duke u përqendruar në rigozitetin metodologjik dhe shkencor.

- Analizë kritike e një artikulli të shkruar: 20 pikë mund të merren nga kandidati për analizën kritike të një artikulli shkencor, të cilën kandidati e paraqet në ditën e intervistimit/prezantimit të konceptit ideor.

Për t'u konsideruar për pranim, kandidati duhet të ketë siguruar 50% të pikëve nga dy elementet e provimit pranues më lart si prag minimal.

Pjesa tjetër e pikëve merret parasysh në rangim sipas kërkesave të konkursit dhe në harmoni me Rregulloren për studime të doktoratës në Universitetin e Prishtinës.

Orientimi në program:

Parimi bazë është që duhet të ekzistojë vazhdimësia e studimeve master në raport me orientimet e ofruara brenda këtij programi të doktoratës, duke përfshirë profilin e programit master dhe temën e masterit. Studenti mund të zgjedhë njërin nga orientimet si më poshtë:

- *Mësimdhënia dhe të nxënit:* mund të orientohen të kualifikuarit master në fushat lëndore (akademike dhe arsimore) të gjuhës dhe letërsisë shqipe, matematikës, shkencave të natyrës, teknologjisë dhe TIK-ut, shkencave shoqërore, apo edukimit për STEAM. Ndërsa për profilin e edukimit të përgjithshëm mund të orientohen të diplomuarit nga programet si 'Mësimdhënia dhe kurrikula', 'Pedagogjia' apo programe të tjera të ngjashme të natyrës së përgjithshme arsimore.

- *Politikat arsimore:* mund të orientohen të diplomuarit nga programet e menaxhimit ose udhëheqjes arsimore dhe pedagogjisë apo programet e tjera të përafërta me fushën e menaxhimit që komisioni i konsideron relevante në kombinim me përvojën profesionale të kandidatëve.

- *Edukimi në fëmijërinë e hershme:* mund të orientohen të diplomuarit nga fusha e edukimit të hershëm, mësimdhënies dhe kurrikulës, pedagogjisë dhe psikologjisë që fokus kanë pasur studimin e edukimit dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme.

- *Edukimi inkluziv:* mund të orientohen të diplomuarit nga fusha e edukimit inkluziv, mësimdhënia dhe kurrikula, pedagogjia dhe psikologjia arsimore/shkollore (me kusht që temat e masterit janë, po ashtu, të fushës së edukimit inkluziv).

Kufizimet dhe kuotat sipas specializimeve dhe kapaciteteve për mentorim: Në orientimet Edukimi në fëmijërinë e hershme, Edukimi inkluziv, Politikat arsimore nuk mund të pranohen më shumë se një kandidat në secilin orientim.

Të diplomuarit nga institucionet jopublike të arsimit të lartë nuk kualifikohen për këtë program sipas nenit 16.5 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit si në vijim:

1. Certifikatën ose ekstraktin e lindjes (jo më të vjetër se gjashtë-6 muaj);
2. Diplomën dhe certifikatën e notave nga nivelet e studimeve paraprake në studimet baçelor, master ose magjistratura shkencore, ndërsa për Fakultetin e Mjekësisë diplomën dhe certifikatën e notave nga niveli i studimeve të integruara (5-6 vjeçare);
3. Kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës duhet t'i nënshtrohen njohjes së diplomës, me qëllim vazhdimin e studimeve, duke ndjekur procedurën sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës;
4. Biografinë;
5. Letrën motivuese (në të cilin arsyetohet interesi për kërkime shkencore/artistike në lëmin përkatës);
6. Konceptin ideor të hulumtimit;
7. Dëshmitë lidhur me suksesin në secilin nivel të studimeve paraprake (arritje të jashtëzakonshme, vlerësime maksimale, dëshmi për performancë të dalluar e të ngjashme);
8. Dëshmitë për njohjen e gjuhës angleze sipas kriterëve të përcaktuara të kriteret e konkursit;
9. Letër zotimi apo konfirmimi i një profesori në fushën përkatëse se është i gatshëm të mentorojë kandidatin (mentor potencial) në temën përkatëse dhe i cili duhet të plotësojë kushtet për mentorim;
10. Dëshmitë lidhur me publikimet/prezantimet nga veprimtaria kërkimore-shkencore (nëse posedojnë).

Aplikimi bëhet në formë elektronike në platformën <http://apliko.uni-pr.edu> dhe duhet të përmbajë dokumentacionin e kërkuar si më sipër.

IV. AFATET E KONKURSIT

- a) Konkursi është i hapur nga data **07.05.2026** deri më **26.06.2026**.
- b) Pjesa profesionale mbahet me prani fizike në terminet e caktuara nga njësitë akademike përkatëse. Informatat për datën, orën dhe sallat e realizimit të pjesës profesionale do të publikohen me kohë në uebfaqet e njësive akademike.
- c) **Rezultati preliminar** do të shpallet më së largu deri më **08.07.2026** në uebfaqe të fakultetit përkatës.
- c) **Ankesat** e kandidatëve duhet të dorëzohen në njësitë përkatëse akademike me datën **09.07.2026** dhe me datën **10.07.2026** deri në orën **16.00**.
- d) **Rezultati përfundimtar**: Njësitë akademike, pas shqyrtimit të raportit të komisionit të ankesave, hartojnë listat e kandidatëve të propozuar në nivel të njësive akademike dhe deri më **15.07.2026** i dërgojnë për shqyrtim në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës (KQSD). Senati i universitetit, bazuar në propozimin e njësive akademike dhe të KQSD-së, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Listat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen në uebfaqet e njësive akademike dhe në uebfaqen e universitetit.
- dh) **Afati i regjistrimit** të kandidatëve të pranuar do të publikohet pas vendimit përfundimtar të senatit.

